



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHENDETESISË-MINISTARSTVO ZDRAVLIA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	07
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-2420
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 20 -
Data: Datum: Date:	04/04/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	04.04.2024
PËR/ZA/TO:	z. Salvador Elmazi- Drejtor i Buxhetit -MFPT
CC:	z. Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve Dr. Shaban Osmanaj, Udhëheqës i Divizionit të Kujdesit Parësor Shëndetësor në MSh
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	Znj. Kadrije Berisha, Zyrtar Kryesor Financiar, Ministria e Shëndetësisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim i KASH 2025-2027 për Grantin Komunal për Shëndetësi

I nderuar z. Elmaz, Drejtor i Buxhetit,

Bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me numër të protokollit 491/2024 të datës 11.03.2024 gjeni të bashkangjitur propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë për Grantin Specifik për Shëndetësinë primare për KASH 2025 - 2027.

Propozim Granti Specifik për Shëndetësinë primare është hartuar bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin nr.04/L-125 Ligji për Shëndetësi si dhe bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësor.

Të bashkangjitura keni:

- Vendimin e Ministrit të Shëndetësisë për Grantin Specifik për Shëndetësi;
- Pjesa narrative me sqarimet për Propozimin e KASH 2024-2026 për Grantin Komunal për Shëndetësi;
- Granti specifik i sqaruar në vlera monetare sipas shërbimeve përkatëse.

Me respekt,

1. Përshkrim i Përgjithshëm

Kujdesi shëndetësor parësor luan një rol vendimtar në promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së përgjithshme të individëve, familjeve dhe komuniteteve, pra, është një komponent thelbësor i sistemit të kujdesit shëndetësor.

Marr parasysh që baza e financimit të kujdesit parësor shëndetësor vjen nga Granti specifik nga niveli qendror, është jashtëzakonisht e rëndësishme që ky grant fillimisht të mbulojë të gjitha shpenzimet në kudër të kujdesit parësor shëndetësor në të gjitha komunat, por që krahas kësaj, shpërndarja e këtij grant të bazohet në kriteret e qarta të cilat pasqyrojnë strategjinë dhe vizionin e MSh për të ofruar një shërbim cilësor shëndetësor.

Sidoqoftë, çështja e sasisë së financimit është e rëndësishme dhe lidhet me nivelin e zhvillimit ekonomik dhe burimeve financiare të disponueshme, po kaq e rëndësishme është edhe cilësia e financimit, brenda kufizimeve sasiore që ekzistojnë e që ka të bëjë me mënyrën se si mjetet e disponueshme shpërndahen në sistemin shëndetësor dhe se a shpërndahen këto mjete sipas nevojave, duke siguruar barazi dhe efikasitet në praktikë.

2. Formula e Financimit

Baza ligjore e cila rregullon çështjen e standardeve që nevojiten për shërbimet e KPSH është Udhëzimi Administrativ për Shëndetësi Nr.04/2020. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ siç përcaktohet edhe në Nenin 1 të këtij Udhëzimi është përcaktimi i institucioneve të KPSH, standardeve të organizimit, funksionimit, veprimtarisë, shërbimeve shëndetësore si dhe kuadrit profesional për ofrimin e shërimit shëndetësor në kujdesin parësor shëndetësor.

Në këtë kuadër, Neni 5 i Udhëzimit Administrativ përcakton organizimin dhe standardet e KPSH si vijon: KPSH organizohet përmes rrjetit të institucioneve shëndetësore në:

- QKMF- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, e cila ofron shërbime shëndetësore në kuadër të KPSH në territorin administrativ të Komunës përkatëse. Numri i QKMF i përgjigjet numrit të Komunave në Kosovë në pajtim me politikat e Ministrisë së Shëndetësisë. QKMF, si institucion i KPSH, organizohet përmes Departamentit të Mjekësisë Familjare, Departamentit të Administratës dhe Barnatores Qendrore.

Në kuadër të QKMF janë njësit përbërëse të saj:

- QMF- Qendra e Mjekësisë Familjare e cila sipas Udhëzimit Administrativ ofron shërbime shëndetësore për jo më pak se dhjetë mijë (10,000) banorë, duke e respektuar kriterin një ekip i Mjekësisë Familjare në dy mijë (2,000) banorë.
- Në nivel që QMF ofrohen shërbime të mjekësisë familjare, të shëndetit oral parandalues, konsultative, diagnostike dhe shërbime të furnizimit me barna.
- AMF- Ambulanca e Mjekësisë Familjare, e cila ofron shërbime shëndetësore deri në dhjetë mijë (10,000) banorë. Në nivel të AMF ofrohen shërbime nga ekipi i mjekësisë familjare dhe ekipi i shëndetit oral.

Sa i përket kriterëve lidhur me profesionistët shëndetësor që ofrojnë shërbime shëndetësore në institucionet e KPSH, Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2020, specifikon profesionistët shëndetësor dhe atë si vijon:

- Specialist i Mjekësisë Familjare;
- Doktor i Mjekësisë;
- Doktor i Stomatologjisë;
- Specialist i Pedodoncisë dhe preventivës;
- Farmacistë të Diplomuar-magjistër të farmacisë;
- Specialist i Biokimisë klinike;
- Infermier i/e diplomuar;
- Mami e diplomuar;
- Teknik laborant;
- Teknik i Farmacisë;
- Teknik/asistent i stomatologjisë;
- Radiologu dhe tekniku i radiologjisë në institucione ku funksionon kabineti i Rtg;
- Profesionistët shëndetësor të tjerë me kualifikim të mesëm dhe të lartë, të përcaktuar në regjistrin zyrtar të Ministrisë; dhe
- Bashkëpunëtor profesional me shkollim jashtë lëmisë së mjekësisë, të evidentuar në regjistrin zyrtar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, në bazë të propozimit të Odës përkatëse të profesionistëve sipas Ligjit të Shëndetësisë.

Ndërsa në QKMF ku funksionon materniteti, është i domosdoshëm Gjinekologu dhe Neonatologu ose Pediatri, po ashtu Udhëzimi Administrativ Nr.04/2020, parasheh që për specialistë nga lëmitë e tjera, mundë të vazhdojnë punën në KPSH si konsulent të Mjekëve Familjarë deri në pensionim.

Përkundër që në Udhëzimin Administrativ Nr.04/2020 jepet një përshkrim i detajuar për profesionistët shëndetësor si më lart, sa i përket numrit të këtyre profesionistëve në kujdesin parësor shëndetësor, Udhëzimi Administrativ le hapësirë për të dëshiruar, pasi që vetëm disa prej profesionistëve mjekësor përcaktohen në numra sipas një standardi në raport me numrin e popullsisë.

Standardi i përdorur për përcaktimin e numrit të domosdoshëm të stafit mjekësor për KPSH sipas Udhëzimit Administrativ Nr.04/2020 për disa prej profesionistëve shëndetësor, është si vijon:

- Ekipi i mjekësisë familjare përbëhet nga Mjeku Familjar dhe dy infermier/e Familjar, që ofrojnë kujdes individual, familjar dhe në bashkësi. Ky Ekip ofron shërbime për dy mijë (2,000) banorë.
- Një doktor i stomatologjisë dhe një teknik/asistent i stomatologjisë në institucionet e KPSH ofron shërbime për pesë mijë (5,000) banorë.

Pra thënë ndryshe, nga gjithsejtë 14 kategoritë e profesionistëve shëndetësor në KPSH të lartpërmendura, për vetëm 4 sosh (Mjek Familjar, Infermier/e, Stomatolog dhe Teknik i Stomatologjisë) Udhëzimi përkufizon një standard për ofrimin e shërbimit shëndetësor në kuadër të institucioneve të KPSH.

Përderisa më lart sqaruar kornizën ligjore, përkatësisht Udhëzimin Administrativ 04/2020 për Shëndetësi, lidhur me përcaktimin e standardeve kryesisht për stafin profesional shëndetësor, në vijim do paraqesim kalkulimin e Grantit specifik për shëndetësi primare për vitin vijues 2024.

Granti specifik për KPSH sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2025-2027.

Bazuar në shkresën e pranuar nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve të datës 11.03.2024 më posht është llogaritur Formula e re e Grantit Specifik për Shëndetësi primare.

3. Granti specifik për shëndetësi për vitin 2025

Propozimi granti specifik për shëndetësi primare nga Ministria e Shëndetësisë për vitin 2025 është në shumë prej **89,596,048** milion euro, si në vijim:

Granti bazë është propozuar në shume prej **83,787,557** euro (pa llogaritur shumën në vlerë prej **5,808,490.00** milion euro për shërbimein urgjent), milion euro duke marre për bazë:

- Kategorinë paga dhe shtesa në sektorin e shëndetësisë në shume prej **61,140,346** euro duke përfshire politiken e re e cila ka vlerë prej **1,570,061** euro.
- Koston për vizitë dhe shërbim në shume prej **14,233,992.00** euro.
- Shpenzime tjera operative në Mallra dhe Shërbime **2,092,429.00** euro.
- Shpenzimet komunale **2,097,600.00** euro.

Politikat në vazhdimësi

Vizita në shtëpi për Shtatëzenat dhe fëmijen në vlerë prej 2,133,390;

Vzita në shtep për kujdesin paliativ në vlerë prej 2,103,000.

Politikat e reja

- Sherbimi urgjencës në vlerë prej **4,978,706** euro dhe
- Intervenimi në fëmijërin e hershme në vlerë prej **1,570,061** euro

Nga kalkulimet e mësipërme shohim se nga total Granti prej 89,324,335 milion euro, 60,877,034 milion apo 76.0% e këtij granti i përket kategorisë së pagave dhe shtesave, ndërsa që pjesa tjetër prej 24.0% shkon në mbulimin e shpenzimeve të tjera qoftë në kategorinë mallra dhe shërbime dhe shpenzimet komunale.

Duke u bazuar në të dhëna primare nga Komunitet e cila përmban të dhënat lidhur me numrin e popullsisë, demografia sipas gjinisë dhe moshës si dhe numrit të personave me nevoja të veçanta, pastaj shpalosen të dhënat lidhur me standardet për mjek dhe infermier si dhe në fund pjesa e institucioneve të KPSH. Në vijim do paraqesim tabelën e të dhënave statistikore me të gjitha detajet e paraqitura.

Nr.	Komuna	Popullsia, Standardet për mjek dhe infermier dhe Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor																			
		Popullsia	Demografia						Standardet për mjek dhe infermier										Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor		
			Gjinia		Moshë		Numri i personave me nevojë të veçanta	Standardet 1 M/2000 banorë	Standardet 01 Stomatolog 5000 banorë	Standardet 01 Farmacitë në QKMF	Standardet 01 Biokëmbat në QKMF	Gjithësej Mjek	Infermiere Familjare	Infermier (për mjek specialist, stomatolog, laborator etj)	Gjithësej (mjek dhe infermiere dhe farmacist)	Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF)	Qendër e Mjekësisë Familjare (QMF) 10.000 banorë	Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF)			
			M	F	Fëmijë të moshës riprodhuese 15-49 vjeç	Numri i fëmijëve 0-14 vjeç															
1	Deçan	40,019	20,123	19,896	10,941	10,471	2,968	50	20	8	1	1	30	40	27	97	1	3	6		
2	Dragash	33,997	17,035	16,962	8,748	8,658	3,139	202	17	7	1	1	26	34	49	109	1	5	8		
3	Ferizaj	108,610	54,841	53,769	23,716	31,566	6,557	1,241	54	24	1	1	80	118	74	272	1	9	5		
4	Fushë Kosovë	34,827	17,621	17,206	9,299	9,996	2,143	293	17	7	1	1	26	34	48	108	1	5	6		
5	Gjakovë	94,556	47,226	47,330	26,654	26,423	12,123	1,130	48	19	1	1	69	94	54	217	1	9	15		
6	Gjilan	90,178	45,354	44,824	19,771	29,288	9,358	1,160	45	18	1	1	65	90	52	207	1	7	10		
7	Gillogovc	58,531	29,733	28,798	18,260	14,317	5,213	211	30	12	1	1	44	60	71	175	1	5	7		
8	Hani i Elezit	9,403	4,836	4,567	1,824	2,778	560	73	5	2	1	1	9	10	7	26	1	0	1		
9	Istog	39,285	19,677	19,608	10,607	10,235	3,093	464	20	8	1	1	30	40	41	111	1	4	8		
10	Junik	6,084	2,995	3,089	1,595	1,681	420	35	3	1	1	1	6	6	8	20	1	0	0		
11	Kaçanik	33,409	16,970	16,439	9,054	9,683	1,940	200	17	7	1	1	26	34	59	119	1	4	8		
12	Kamenicë	36,085	18,600	17,485	16,505	8,900	2,143	360	18	7	1	1	27	36	57	120	1	3	17		
13	Klinë	38,496	19,293	19,203	10,272	11,398	2,606	200	19	8	1	1	29	38	15	82	1	3	9		
14	Leopasavic	13,773	6,969	6,804	3,443	2,754	965		7	3	1	1	12	14	15	41	1	0	1		
15	Lipjan	57,605	29,325	28,280	15,355	17,461	7,042	706	29	12	1	1	43	58	65	166	1	4	7		
16	Malishevë	54,614	25,901	28,713	36,430	20,758	3,622	640	35	14	1	1	51	70	29	150	1	6	7		
17	Mamushë	5,508	2,672	2,836	2,543	2,670	737	15	3	1	1	1	6	6	3	15	1	0	0		
18	Mitrovicë	71,909	36,275	35,634	18,624	20,351	5,074	1,200	36	14	1	1	52	72	76	200	1	11	10		
19	Novobërdë	6,730	3,466	3,264	1,726	1,643	732	41	3	1	1	1	6	7	8	21	1	1	0		
20	Obiliq	21,549	10,885	10,664	5,636	6,419	1,239	337	11	4	1	1	17	22	34	73	1	1	4		
21	Pejë	96,451	50,466	45,985	21,930	33,320	10,783	1,047	57	23	1	1	82	116	105	303	1	9	14		
22	Podujevë	88,499	44,955	43,544	23,385	27,061	5,122	879	44	18	1	1	64	88	68	220	1	3	18		
23	Prishtinë	198,897	99,361	99,536	54,800	51,403	25,008	2,143	99	40	1	1	141	198	156	495	1	15	15		
24	Prizren	177,781	89,176	88,605	48,677	49,199	12,502	1,602	89	36	1	1	127	178	116	421	1	15	27		
25	Rahovec	56,208	28,512	27,696	15,393	16,081	3,852	377	28	11	1	1	41	56	77	174	1	7	7		
26	Shtërpçë	6,949	3,554	3,395	1,707	1,777	688	23	3	1	1	1	6	7	8	21	1	0	2		
27	Shtime	27,324	13,850	13,474	5,874	7,877	2,200	38	14	5	1	1	21	28	20	69	1	4	0		
28	Skenderaj	50,858	25,646	25,212	16,515	14,925	4,150	3,758	26	10	1	1	38	52	50	140	1	5	8		
29	Suharekë	59,722	29,478	30,244	16,413	17,409	4,104	610	30	12	1	1	44	60	38	142	1	6	11		
30	Viti	46,987	23,686	23,301	12,310	14,167	3,028	439	23	9	1	1	34	46	25	105	1	4	7		
31	Vushtrri	69,870	36,004	33,866	18,146	19,634	4,508	800	35	14	1	1	51	70	55	176	1	10	9		
32	Zubin Potok	6,616	3,408	3,208	1,456	1,588	476	38	3	1	1	1	6	7	-	13	1	0	0		
33	Zveçan	7,481	3,661	3,820	95	117	45	1	4	1	1	1	7	7	-	14	1	1	0		
34	Graçanicë	10,675	5,428	5,247	2,463	2,661	993	81	5	2	1	1	9	11	-	20	1	3	11		
35	Kllokot	2,556	1,416	1,140	688	670	214	18	1	1	1	1	4	3	7	14	1	0	1		
36	Mitrovica Veriore	12,326	6,272	6,054	2,686	2,931	879	82	6	2	1	1	10	12	10	32	1	0	0		
37	Partesh	1,787	922	865	477	340	202	-	1	1	1	1	4	2	-	6	1	0	2		
38	Ranillug	3,866	1,969	1,897	1,012	393	259	-	-	-	1	1	2	4	-	6	1	0	0		
	Total	1,780,021	897,561	882,460	495,030	488,245	150,187	20,494	905	364	38	38	1,345	1,828	1,527	4,700	38	162	261		

Përveç Udhëzimit Administrativ 04/2020 që rregullon çështjen e organizimit, personelit mjekësor, shërbimeve etj., Ligji për Financat e Pushteti Lokal Nr.03/L-049 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-108, gjegjësisht neni 25 i këtij ligji kërkon që, citojmë: “Granti Specifik për Shëndetësi do të përcaktohet dhe do t’u alokohet komunave në përputhje me formulën e përcaktuar nga Komisioni i Granteve. Kjo formulë bazohet në popullsinë e normalizuar dhe standardet e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë. Normalizimi merr parasysh moshën dhe strukturën gjinore të popullsisë së regjistruar të ofruesit të shëndetësisë primare si dhe numrin e personave të moshuar dhe personave me nevojë të veçanta shëndetësore.

Sa i përket të dhënave për numrin e popullsisë, dhe strukturën demografike të saj, të dhënat janë marr nga Agjencia e Statistikave të Kosovës nga regjistrimi i fundit i popullsisë që është bërë në vitin 2011, gjë që për disa komuna si Prishtina dhe Fushë Kosova, gjendja e tanishme rezultoi të jetë mjaft e ndryshme sa i përket numrit të popullsisë veçanërisht në këto dy komuna.

Në kalkulimin e Grantit, faktorëve demografik si gjinia dhe moshë, nuk i është dhënë ndonjë peshë e veçantë në kalkulimin e numrit të stafit mjekësor, ndërsa kalkulimet lidhur me standardet për mjek dhe infermier bazohen në numrin e përgjithshëm të popullsisë dhe atë si vijon:

3.1 Pagat dhe shtesat

Kriteret standarde për kalkulimit të numrit të stafit mjekësor, gjegjësisht kalkulimit lidhur me shpenzimet e pagave dhe shtesave në kuadër të Grantit specifik për shëndetësi primare bazohet në vendimin e Ministrit të Shëndetësisë. Ky vendim përcakton kriteret e financimit të Kujdesit Parsor shëndetësor ndërsa nuk hyn në qështjet tjera të cilat janë të përcaktuara më legjislacionin në fuqi.

Një çështje mjaft e rëndësishme në kategorinë e pagave dhe shtesave është edhe çështja e strukturës së pagave, gjegjësisht strukturës së stafit në kuadër të institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor. Lidhur me këtë mund të themi se i gjithë stafi ndahet në:

- a. Stafi Mjekësor dhe
- b. Stafi Administrativ.

a. Stafi Mjekësor

Çështja e pagave dhe shtesave si një prej komponentëve kryesore të Grantit specifik për KPSH, ku janë paraqitur kalkulimet lidhur me një pjesë të numrit të stafit duke ju referuar Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2020 dhe ka vlerë financiare prej 61.5 mil euro apo 76.00 % të totalit të Grantit Secifik për Shëndetësi.

Standartet sipas UA 04/2020 për KPSH

- ~~Mjek Familjar (1 Mjek Familjar për 2,000 banor);~~
- Stomatolog (1 Stomatolog për 5,000 banor);
- Infermier/e (2 Infermier/e për 1 Mjek Familjar); dhe
- Teknik/Asistent i Stomatologjisë (1 Teknik/Asistent i Stomatologjisë për 5,000 banor).

* Për katër (4) profesionistët shëndetësor (Mjek Familiar, Infermier/e familjare, Mjek stomatolog dhe Teknik Stomatolog) standartet janë të bazuara në UA 04/2020 për KPSH.

* Për shtatë (7) profesionistët tjera (Pedodont, Mjek biokimist, Farmacist i Diplomuar, Teknik i Farmacisë, Teknik Laborant, Radiolog, Teknik i Radiologjisë). UA 04/2020 për KPSH nuk i ka përcaktuar standartet. Propozimi i Standarteve në këtë formulë është bërë vetëm për financim.

Tab 1. Paga dhe Shtesa-Stafi mjeksor

KOMUNA:	Të gjitha		Vlera e koeficientit: 110.0		Nr. Banorëve: 1,779,249	Ekipi Emergjencës në: 15,000		
	Shtesa mbi pagën %:		10%			Shërbimi i Urgjencës		
Stafi Mjeksor	Raporti për një njësi stafi	Nr. i Stafit në KPSH (I kalkuluar)	Koeficienti	Shtesat	Paga Bruto Mujore	Shpenzimet vjetore për Paga dhe Shtesa	Nr. i Stafit (Urgjencës)	Shpenzi met për Paga dhe Shtesa (Urgjencës)
Mjek Familjar:	2,000 Banor	909	12.00	<input type="checkbox"/>	1,320	15,118,488	137	2,278,584
Infermier/e Familjare:	1,000 Banor	1,818	5.40	<input type="checkbox"/>	594	13,606,639	274	2,050,726
Mjek Stomatolog:	5,000 Banor	374	7.40	<input type="checkbox"/>	814	3,835,894	-	-
Teknik Stomatolog:	5,000 Banor	374	5.40	<input type="checkbox"/>	594	2,799,166	-	-
Pedodont:	5,000 Banor	122	12.00	<input type="checkbox"/>	1,320	2,029,104	-	-
Mjek Biokimist:	50,000 Banor	58	12.00	<input type="checkbox"/>	1,320	964,656	-	-
Farmacist i Diplomuar:	1 QKMF	38	12.00	<input type="checkbox"/>	1,320	632,016	-	-
Teknik i Farmacisë:	50,000 Banor	96	5.40	<input type="checkbox"/>	594	718,502	-	-
Teknik Laborante:	10,000 Banor	195	5.40	<input type="checkbox"/>	594	1,459,458	-	-
Radiolog:	2 QKMF	76	12.00	<input type="checkbox"/>	1,320	1,264,032	-	-
Teknik Radiologjise:	4 QKMF	152	5.40	<input type="checkbox"/>	594	1,137,629	-	-
Mami e diplomuar:	- QKMF	-	5.40	<input type="checkbox"/>	594	-	-	-
Mjeku gjinekolog:	- QKMF	-	12.00	<input type="checkbox"/>	1,320	-	-	-
Mjek pediater-Neonatolog:	- QKMF	-	12.00	<input type="checkbox"/>	1,320	-	-	-
Bashkpuntor profesional:	- QKMF	-	5.40	<input type="checkbox"/>	594	-	-	-
Logoped:	70,000 Banor	48	5.60	<input type="checkbox"/>	616	372,557	-	-
Psikolog:	70,000 Banor	48	7.00	<input type="checkbox"/>	770	465,696	-	-
Fizioterapeut:	70,000 Banor	48	5.60	<input type="checkbox"/>	616	372,557	-	-
Punëtor Social:	70,000 Banor	48	5.40	<input type="checkbox"/>	594	359,251	-	-
Gjithsejt Staf Mjeksor:		4,404				44,906,677	411	4,329,310
Staf zëvendësues: 15 %		661				6,815,586	62	649,396
Gjithsejt Staf Mjeksor & zëvendësues:		5,065				51,642,679	473	4,978,706
Stafi mjeksor për 1,000 banor:		2.50						

Lidhur me profesionet e paraqitura në tabelën nr. 1 me ngjyrë të hijëzuar (Logoped, Psikolog, Fizioterapeut si dhe Punëtor Social), të njëjtat janë propozuar dhe janë në kuadër të Vendimit të Ministrit të Shëndetësisë është politikë e re.

Sa i përket kategorisë “Stafi zëvendësues” i paraqitur në tabelën më lart, këtu kemi të bëjmë me kalkulimin e stafit të nevojshëm që duhet të zëvendësojë stafin mjekësor kur ata nuk gjenden në punë, qoftë si rezultat i pushimeve apo trajnimeve, etj.

Kalkulimet lidhur me këtë pjesë do i paraqesim në tabelën si vijon:

Tabela 2: Kalkulimet lidhur me % e stafit zëvendësues

Fondi i përgjithshëm i ditëve të punës (52 jave x 5 ditë pune)	260
Mesatarja e ditëve në pushim vjetor:	25
Ditë të festave:	12
Mesatarja e ditëve në trajnime:	2
Mesatarja e ditëve në pushim mjekësor:	2
Numri total i ditëve me mungesë në punë:	41
% e ditëve të mungesës në punë nga totali i ditëve:	15%

b. Stafi Administrativ

Stafit jo mjekësor apo administrativ, Udhëzimi Administrativ për Shëndetësi Nr.04/2020, nuk përcakton ndonjë kriter të caktuar lidhur me stafin administrativ, përveç që përcakton që çdo QKMF ka një Drejtor, ndërsa që nëse numri i përgjithshëm i stafit është mbi 100, atëherë duhet të ketë edhe Zëvendës Drejtorin.

Ndërsa në dokumentin “Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare”, ofrohet një pasqyrë me e detajuar lidhur me formën dhe strukturën e organizimit dhe funksionimit të QKMF, rrjedhimisht të shërbimeve në kuadër të KPSH e që janë

- Departamenti i Mjekësisë Familjare me këtë përbërje:
 - Sektori i Mjekësisë Familjare;
 - Njësia e SISH;
 - Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit;
 - Sektori i Shëndetit Oral Preventiv;
 - Sektori i Kujdesit Urgjent;
 - Sektori konsultativë dhe Diagnostikë;
 - Shërbimet konsultative;
 - Kabineti Radiologjik;
 - Laboratori.
- Departamenti i Administratës së QKMF me këtë përbërje:
 - Njësia ose Zyra e personelit;
 - Njësia ose Zyra Juridike;
 - Njësia ose Zyra për buxhet dhe financa;
 - Njësia ose Zyra e prokurimit;
 - Njësia ose Zyra për shërbime teknike.
- Barnatorja Qendrore.

Pothuajse në të gjitha komunat ekziston ndarje në tri Departamente ashtu siç përcaktohet edhe në dokumentin e mësipërm, mirëpo dallimet ndërmjet komunave vërehen në njësitë përbërëse dhe numrin e stafit brenda këtyre departamenteve.

Tab.2 Paga dhe Shtesa-Stafi Administrativ

Stafi Administrativ	Raporti për një njësi stafi		Nr. i Stafit në KPSH (i kalkuluar)	Koeficienti	Paga Bruto Mujore	Shpenzimet për paga dhe Shtesa	Numri i Stafit (Urgjencës)	Sh. Për paga dhe Shtesa (Urgjencës)	
Drejtor QKMF:	1	QKMF	38	12.50	<input type="checkbox"/>	1,375	658,350	-	-
Zv. Drejtor QKMF:	1	QKMF	23	12.00	<input type="checkbox"/>	1,320	382,536	-	-
Kryeshef Dep. Admin:	1	QKMF	38	8.30	<input type="checkbox"/>	913	437,144	-	-
Kryeinfermieri i QKMF:	1	QKMF	38	6.00	<input type="checkbox"/>	660	316,008	-	-
Udhëheqës Njësie:	2	QKMF	76	7.20	<input type="checkbox"/>	792	758,419	-	-
Koordinator SISH:	1	QKMF	38	7.20	<input type="checkbox"/>	792	379,210	-	-
Depoist:	1	QKMF	38	5.00	<input type="checkbox"/>	550	263,340	-	-
Arkivist:	1	QKMF	38	5.00	<input type="checkbox"/>	550	263,340	-	-
Shtëpiak:	1	QKMF	38	3.76	<input type="checkbox"/>	414	198,032	-	-
Asistent:	2	QKMF	76	4.10	<input type="checkbox"/>	451	431,878	-	-
Zyrrar:	3	QKMF	114	5.00	<input type="checkbox"/>	550	790,020	-	-
Shofer:	2	QKMF	76	3.80	<input type="checkbox"/>	418	400,277	137	721,552
Pastrues:	5,000	Banor	465	3.80	<input type="checkbox"/>	418	2,449,062	-	-
Sigurim:	50,000	Banor	58	3.76	<input type="checkbox"/>	414	302,259	-	-
Gjithsejt Staf Administrativ:			1,154			-	8,029,874	137	721,552
Staf zëvendësues:		15%	173			-	1,204,481	21	108,233
Gjithsejt Staf Admin. & zëvendësues:			1,327			-	9,234,355	158	829,784
TOTAL Staf Mjekësor & Administrativ:			5,602			-	53,467,112	548	5,050,861
TOTAL Staf Mjekësor, Admin. & zëvendësues:			6,442			-	61,487,179	630	5,808,490

Formula e Grantit Specifik për Shëndetësi po ashtu kalkulon numrin e stafit mjekësor për 1,000 banorë duke sinjalizuar edhe nëse koeficienti që rezulton nga kriteret e përdorura është nën standardin e lejuar nga OBSH.

Sa i përket stafit administrativ, po ashtu korniza ligjore aktuale nuk specifikon ndonjë kriter të caktuar lidhur me numrin e këtij stafi, përveç që në Udhëzimin Administrativ 04/2020, specifikohen që një QKMF duhet të ketë një drejtor dhe po ashtu nëse numri i personelit është mbi 100 të punësuar duhet të ketë edhe një zëvendës drejtor dhe kalkulimi për Stafin Administrativ është bërë bazuar në hulumtimet në teren dhe shërben vetëm si bazë e financimit dhe jo plotësimi të domësdoshëm të këtyre pozitave nga Kujdesi Parsor Shëndetësor.

3.2 Mallrat dhe shërbimet

Në kuadër të Grantit specifik për KPSH, të gjitha shpenzimet lidhur ndahen në dy grupe të mëdha, siç janë: Granti Bazë; dhe Politikat në vazhdimësi. Kategoria “Mallrat dhe Shërbimet” përbën pjesën tjetër pas pagave me një pjesëmarrje në Granti specifik për vitin 2025 në vlerë prej 24% të grantit të përgjithshëm për KPSH.

Në kuadër të llogaritjes së shpenzimeve për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” në Grantin Bazë, kemi dy lloje shpenzimesh, dhe atë për: Numrin e vizitave të mjeku dhe numrin e shërbimeve që merr një pacient pas vizitës të mjeku si psh marrja e një vaksine, lidhja e një plage, parrja e gjakut për analiza etj

Lidhur me numrin e vizitave, në Grantin Bazë janë paraparë 2 vizita për kokë banori, ndërsa shpenzimet për një vizitë janë kalkuluar në shumën prej 2.00 EUR. Po ashtu, edhe për shërbimet është paraparë numër i njëjtë i shërbimeve dhe kosto e njëjtë sikur tek vizitat, pra kemi 2 shërbime për kokë banori me nga 2 EUR shpenzime të kalkuluar për një shërbim. Ndërsa për politikat në vazhdimësi, në Grantin specifik janë kalkuluar këto lloje shpenzimesh: Vizitat në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë; dhe Kujdesi paliativ.

Sa i përket vizitave në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë, kalkulimi është bazuar në të dhënat lidhur me numrin e femrave të moshës riprodhuese 15-49 vjeç, duke planifikuar që çdo e pesta grua duhet të vizitohet, pastaj këtë numër duke e shumëzuar me një mesatare prej 3.46 vizitave në vit, apo në terma të përgjithshëm që i bije që numri i vizitave përgjatë një viti të arrij mbulimin e 70% të numrit të përgjithshëm të femrave të moshës riprodhuese 15-49 vjeç. Numri i fituar i vizitave më pas është shumëzuar me shpenzimet për një vizitë që janë kalkuluar të jenë 10 EUR.

~~Ndërsa te numri i vizitave për kujdesin paliativ, kalkulimi është bazuar në numrin e personave të moshuar mbi 65 vjeç, duke parashikuar që përafërsisht një e treta e këtij numri të vizitohet. Numri i fituar i këtyre vizitave më pas është shumëzuar me shpenzimet për një vizitë që janë kalkuluar të jenë 20 EUR.~~

Tab.3. Kalkuklimi për Mallra dhe Shërbime

Mallra dhe Shërbime	Planifikimi i vizitave /shërbimeve	Nr.i vizitave /shërbimeve	Kosto për njësi	Shuma totale vjetore		
Planifikimi i Vizitave:	2.0 Banor	3,558,498	2.00	7,116,996	-	-
Planifikimi i Shërbimeve:	2.0 Banor	3,558,498	2.00	7,116,996	-	-
Vizitat në shtëpi për shtat.&fëmij:	7.0 Banor	213,339	10.00	2,133,390	-	-
Vizitat në shtëpi për kujd.paliativ:	0.7 Banor	105,150	20.00	2,103,000	-	-
Trajtimi i mbeturinave mjeksore:	1 Kg	60,096	4.50	270,432	-	-
Kampanja informuese:	1 QKMF	38	5,000.00	190,000	-	-
Trajnime për stafin mjeksor	2 Trajnime	8,896	150.00	1,334,400	-	-
Shpenzimet e mirëmbajtjes së obj.:	227 IKPSH	99,199	3.00	297,597	-	-
Mallra dhe Shërbime:				20,562,811		

Në kuadër të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, janë kalkuluar dy vizita dhe dy shërbime, secila nga këto me një kosto prej 2 euro për vizitë/shërbim. Vlerat janë marr si të mirëqena nga kalkulimet që janë bërë edhe në Grantin për vitin 2024, bazuar në shpenzimet e ndodhura ku përfshihen ndër të tjera shpenzimet si: higjiena, mirëmbajtja e pajisjeve, zhvlerësimi, materiali shpenzues për zyrë si letër printer etj.

Sa i përket vizitave në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë, si dhe për kujdesin paliativ, kalkulimi është bazuar në Vendimin Nr.332/XI/2021, të datës 11.11.2021 i lëshuar nga Ministri i Shëndetësisë përmes së cilit aprovohet Plani i veprimit për vizitat në shtëpi. Programi i vizitave në shtëpi përfshinë një numër standard të vizitave: Dy vizita ofrohen për gratë gjatë shtatzënisë, ndërsa pesë vizita për fëmijët prej 0 deri në 3 vjet.

3.3 Shpenzimet komunale

Tab.4. Kalkulimi për shpenzimet komunale

Shpenzimet Komunale	Raporti për një njësi	Numri i kalkuluar i njësie	Kosto mujore për një njësi	Shuma totale vjetore		
Shpenzimet Komunale:	1	IKPSH 437	400.00	2,097,600	-	-
Shpenzimet Komunale:				2,097,600		-

Kalkulimi i Shpenzimeve komunale është bërë bazuar në Kriteret minimale për Numrin e njërive të objekteve sipas UA/2020 për KPSH më kosto prej 400.00 për njësi.

4. Politikat në vazhdimësi

4.1 Vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë

Nevojitet që në kuadër të Grantit specifik për shëndetësi të llogariten edhe shpenzimet e parapara për programin e vizitave shtëpiake të infermiereve familjare për shëndetin e nënës dhe fëmijëve, i cili ka treguar rezultate shumë të mira fillestare dhe pritet të zgjerohet në të gjitha komunat e vendit në vitet në vazhdim, me vizionin final uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së nënave dhe fëmijëve në vendin tonë.

Ky aktivitet është përcaktuar edhe në kuadër të Programit të Qeverisë për reforma ekonomike (reformat strukturale në sektorin social) si dhe në kuadër të obligimeve të agjendës evropiane.

Kjo politikë është bazuar në planin e veprimit të aprovuar me numër të protokollit 05-7166 me datën 08.11.2021. Kosto për një vizitë është 10 euro.

4.2 Vizitat në shtëpi për kujdes paliativ

Në kuadër të Grantit specifik për shëndetësi, nevojitet që të llogariten edhe shpenzimet e parapara për programin e vizitave për kujdes paliativ (pacientit me sëmundje të rënda dhe në stadet e fundit të jetës). Ky program duhet të zgjerohet dhe të zbatohet në rradhë të parë në Kujdesin Parësor Shëndetësor, duke synuar zhvillimin e shërbimit i cili do të ofrojë kujdes 24 orësh për këtë kategori të pacientëve! Një vizitë e ekipit mjekësor me shërbimet e domosdoshme është vlerësuar të ketë kosto prej 20 Euro.

5. Politikat e reja

Politikat e reja të Ministrisë së Shëndetësisë janë:

- Intervenimi në fëmijërinë e hershme e cila në vitin e parë ka kosto në vlerë prej 1,570,061 dhe staf të ri 192;
- Shërbimi i Urgjencës në KPSH në vlerë prej totale prej 5,808,490.

5.1 Nderhyrja në fëmijërinë e hershme (NFH)

Shërbimet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme (NFH) /Early Childhood Intervention - ECI] janë shërbime të cilat ofrohen për fëmijët 0-6 vjeç me ngecje në zhvillim apo aftësi të kufizuara. Qëllimi i përgjithshëm i këtyre shërbimeve është të përmirësojë rezultatet zhvillimore të fëmijëve duke nxitur zhvillimin optimal dhe duke i përgatitur fëmijët për pjesëmarrje të suksesshme në shoqëri, përfshirë sistemin edukativ dhe arsimor.

Bazuar në Analiza e Situatës së shërbimeve të NFH, të realizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM-ZKM) në Dhjetor 2023, në Kosovë ka mungesë të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ngecje në zhvillim. Gjetjet e analizës tregojnë se shërbimet ekzistuese, të ofruara kryesisht nga sektori privat dhe organizatat joqeveritare, kanë kosto të papërbalueshme dhe/ose janë vështirë të qasshme. Andaj, analiza rekomandon krijimin e shërbimeve të NFH-së të cilat janë të qasshme, pa kosto për familjet, dhe gjithëpërfshirëse.

Shërbimet e NFH-së ofrohen nga ekupe multidisciplinare, duke reflektuar kështu nevojat diverse të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Organizata ndërkombëtare rekomandojnë që ekipi minimal i NFH-së të përbëhet nga psikologu, logopedi, fizioterapeuti/ergoterapeuti, punëtori social, mjeku/infermieri, si dhe edukatori (nëse është i qasshëm) në mënyrë që të bëhet ndërlidhja me edukimin parashkollor. Bazuar në përvojën e marrë nga vizita studimore e përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë, MASHTI-t dhe MFLT-së, të realizuar në nëntor 2023 në Portugali – vend i cili njihet për systemin e avancuar të NFH-së – është vlerësuar se Kosova ka potencial për krijimin e shërbimeve të NFH-së brenda Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH). Kjo mund të arrihet përmes rekrutimit të profesionistëve shtesë në KPSH të cilët janë të domosdoshëm për ofrimin e shërbimeve, që janë: psikologu, logopedi, fizioterapeuti, dhe punëtori social.

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse, krijimit dhe kompletimit të ekipit për NFH/ECI, në institucionet e KPSH, në kuadër të Formulës për Grantin Specifik për Shëndetësi, duhet të kërkohen dhe të punësohen në total numri i stafit është 192 në vlerë financiare prej 1,570,061.

- Psikologu - çdo 70,000 banor një
- Logopedi - çdo 70,000 banor një
- Fizioterapeuti - çdo 70,000 banor një
- Punëtori social - çdo 70,000 banor një

Tab.5. Stafi i nevojshëm për realizimin e politikës së re Intervenimi në fëmijërin e hershme

Nr.	Komuna	Banor	Nr_Logoped	Nr_Psikolog	Nr_Fizioterapeut	Nr_Punëtor Social
38	Të gjitha	1,779,249	48	48	48	48
1	Deçan	40,019	1	1	1	1
2	Dragash	33,997	1	1	1	1
3	Ferizaj	108,637	2	2	2	2
4	Fushë Kosovë	34,827	1	1	1	1
5	Gjakovë	94,556	2	2	2	2
6	Gjilan	90,178	2	2	2	2
7	Gillogovc	58,531	1	1	1	1
8	Hani i Elezit	9,403	1	1	1	1
9	Istog	39,285	1	1	1	1
10	Junik	6,064	1	1	1	1
11	Kaçanik	33,409	1	1	1	1
12	Kamenicë	36,085	1	1	1	1
13	Klinë	38,496	1	1	1	1
14	Leposavic	13,773	1	1	1	1
15	Lipjan	57,825	1	1	1	1
16	Malishevë	54,613	1	1	1	1
17	Mamushë	5,508	1	1	1	1
18	Mitrovicë	71,909	2	2	2	2
19	Novobërdë	6,730	1	1	1	1
20	Obiliq	21,549	1	1	1	1
21	Pejë	96,451	2	2	2	2
22	Podujevë	88,499	2	2	2	2
23	Prishtinë	198,897	3	3	3	3
24	Prizren	176,781	3	3	3	3
25	Rahovec	56,208	1	1	1	1
26	Shtërpcë	6,949	1	1	1	1
27	Shtime	27,324	1	1	1	1
28	Skenderaj	50,858	1	1	1	1
29	Suharekë	59,722	1	1	1	1
30	Viti	46,989	1	1	1	1
31	Vushtrri	69,870	1	1	1	1
32	Zubin Potok	6,616	1	1	1	1
33	Zveçan	7,481	1	1	1	1
34	Klllokot	2,556	1	1	1	1
35	Mitrovica Veriore	12,326	1	1	1	1
36	Partesh	1,787	1	1	1	1
37	Ranillug	3,866	1	1	1	1
38	Graçanicë	10,675	1	1	1	1

5.2 Shërbimi i Urgjencës në KPSH në vlerë prej 4,978,706.00 euro staf mjekësor dhe 829,784.00 staf administrativ

Një çështje tjetër që lidhet me numrin e stafit mjekësor në institucionet e KPSH, ka të bëjë edhe me funksionimin e shërbimit të urgjentës. Ligji Nr. 05/L-024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent, përkatësisht Neni 5 i këtij ligji përcakton se, citojmë: “Shërbimi mjekësor emergjent është pjesë përbërëse e sistemit të kujdesit shëndetësor, i cili ofrohet pa ndërprerë njëzet e katër (24) ore në ditë, shtatë (7) ditë në javë dhe organizohet si në vijim: i) Shërbimin mjekësor emergjent para spitalor; ii) Shërbimin mjekësor emergjent spitalor sekondar dhe terciar. Shërbimi mjekësor emergjent para spitalor organizohet në Shërbimin e Mjekësisë Emergjente”.

Pra, Shërbimi Mjekësor Emergjent (SHME), nuk është pjesë integrale e kujdesit parësor shëndetësor dhe si i tillë nuk do duhej të afektonte fare këtë pjesë të shërbimit mjekësor, sidoqoftë në dispozitat kalimtare të ligjit të lartpërmendur për SHME, përkatësisht paragrafi 2 i Neni 31 të Ligjit Nr.05/L-024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent, thotë, citojmë: “Deri në funksionalizimin e QKSHME dhe njërive të saja, shërbimet mjekësore emergjente para spitalore ofrohen nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në komunat përkatëse.”

Granti i kalkuluar për vitin vijues 2023, pavarësisht që nuk kalkulon numrin e stafin të nevojshëm për SHME, përsëri mbulon shpenzimet edhe për këtë pjesë të shërbimit, me vet faktin që shpenzimet e kalkuluara për vitin vijues bazohen në ato të ndodhura, siç kemi përmendur edhe më lart gjatë sqarimeve që i janë bërë kësaj kategorie buxhetore. Me qëllim që të bëhte mbulimi i përgjithshëm i të gjitha shërbimeve të Urgjencës duhet të shtohet staf shtese si politikë e re. _____

Numri i stafit mjekësor në institucionet e KPSH, ka të bëjë edhe me funksionimin e shërbimit të emergjencës. Ligji Nr. 05/L-024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent, përkatësisht Neni 5 i këtij ligji përcakton se, citojmë: “Shërbimi mjekësor emergjent është pjesë përbërëse e sistemit të kujdesit shëndetësor, i cili ofrohet pa ndërprerë njëzet e katër (24) ore në ditë, shtatë (7) ditë në javë dhe organizohet si në vijim: i) Shërbimin mjekësor emergjent para spitalor; ii) Shërbimin mjekësor emergjent spitalor sekondar dhe terciar. Shërbimi mjekësor emergjent para spitalor organizohet në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Emergjente”.

Pra, Shërbimi Mjekësor Emergjent (SHME), nuk është pjesë integrale e shërbimit primar shëndetësor dhe si i tillë nuk do duhej të afektonte fare këtë pjesë të shërbimit mjekësor, sidoqoftë në dispozitat kalimtare të ligjit të lartpërmendur për SHME, përkatësisht paragrafi 2 i Neni 31 të Ligjit Nr.05/L-024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent, thotë, citojmë: “Deri në funksionalizimin e QKSHME dhe njërive të saja, shërbimet mjekësore emergjente para spitalore ofrohen nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në komunat përkatëse.”

Duke pasur parasysh që ligji i lartpërmendur ende nuk është në zbatim, si pasojë e kësaj e gjithë barra lidhur me ofrimin e shërbimeve mjekësore emergjente para spitalore bije mbi QKMF e komunave përkatëse ku ky shërbim përcaktohet. Ku për funksionim të këtij shërbimi duhen 473 staf mjekësor dhe 137 dhe 158 staf administrativ dhe kosto totale prej 5,808,490.

6. Financimi për shëndetësinë sekondare për komunat Graçanicë, Shtërpçë dhe Mitrovicë Veriore:

Meqë nuk ka standarde për Financimin e Shëndetësisë Sekontare Ministria e Shëndetësisë kërkonë që të vlerësohet për financim historik për nivelin dytësor për tri komunat minoritare, duke insistuar që këto komuna të përgatisin dhe dorëzojnë në MSh.

Tabela Nr.1: Financimi për shëndetësinë sekondare

Nr	Komuna	Shuma (euro)
1	Shtërpçë	522,371
2	Mitrovica e veriut	989,935
3	Graçanicë	1,090,771
	Totali	2,603,077

Përmbledhje financiare-Granti specifik për Shëndetësi primare

Propozimi granti specifik për shëndetësi primare nga Ministria e Shëndetësisë për vitin 2024 është në shumë prej **89,956,080.00** milion euro, si në vijim:

Granti bazë është propozuar në shume prej **83,787,557** euro (pa llogaritur shumën në vlerë prej **5,808,490.00** milion euro për shërbimein urgjent), milion euro duke marre për bazë:

- kategorinë paga dhe shtesa në sektorin e shëndetësisë në shume prej **61,140,346** euro duke përfshire politiken e re e cila ka vlerë prej **1,341,094**euro.
- koston për vizitë dhe shërbim në shume prej **14,233,992.00** euro.
- Shpenzime tjera operative në Mallra dhe Shërbime **2,092,429.00** euro.
- Shpenzimet komunale **2,097,600.00** euro.

Po ashtu nga Ministria e Shëndetësisë janë propozuar politikat në vazhdimësi me kosto prej **4,236,390** euro të cilat janë:

- Vizitat në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë (vizita x 10 euro) në shumë prej **2,133,390.00** euro,
- Vizitat e kujdesit paliativ (vizita x 20 euro) në shumë prej **2,103,000.00** euro,

Politikat e reja të Ministrisë së Shëndetësisë janë:

- **Indervenimi në fëmijërin e herëshme** e cila në vitin e parë ka kosto në vlerë prej **1,570,061** dhe staf të ri **192**.
- **Shërbimi i Urgjencës në KPSH** në vlerë prej **4,978,706.00** euro staf mjekësor dhe **829,784** staf administrativ.

Tabela 8: Granti specifike për Shëndetësi primare, granti bazë për vitin 2025-2027

Nr.	Komuna	Banor	Gjinia_M	Gjinia_F	Femra_15-49	Mosha_<14	Mosha_>65	Nevoja_të_veqanta	Qendër_Kryesore_të	Qendër_e_Mjekësisë	Ambulanca_të	Nr_TOT_Staf_af	Pg_TOT_Staf_i	Nr_TOT_Staf_af	Pg_TOT_Staf_af	Nr_TOTAL_Staffit2	PAGAT_TOTA_L2	TOT_Mallra_&Shërbime	Pg_Shpenszimet	Pg_Mirëm_baltia_e	TOT_GRANT_I_KPSH	Nr_TOT_Staf_af	Pg_TOT_Urgjencia_2	TOTAL_GRANT1	Totali_për_vitin_2026	Totali_për_vitin_2027
38	Të qiltha	1,779,249	897,304	881,945	495,030	509,003	150,187	20,494	28	162	261	5,065	51,905,991	1,327	9,234,355	6,392	81,140,346	20,252,014	2,047,600	297,597	83,737,557	690	5,808,490	89,596,048	94,075,650.11	98,779,642.62
1	Decan	40,019	20,123	19,896	10,941	10,471	2,968	50	1	3	6	118	1,212,958	32	233,857	151	1,446,815	439,994	48,000	6,810	1,941,619	14	127,193	2,068,812	2,172,252.73	2,280,865.37
2	Dragash	33,997	17,035	16,962	8,748	8,658	3,139	202	1	5	8	98	999,057	35	245,971	132	1,245,027	387,203	57,600	8,172	1,698,002	14	127,193	1,825,195	1,916,455.16	2,012,277.92
3	Ferizaj	108,637	54,841	53,796	23,716	31,566	6,557	1,241	1	9	5	286	2,935,007	48	318,525	335	3,253,532	1,184,741	72,000	10,215	4,520,488	37	339,182	4,859,670	5,102,653.35	5,357,786.02
4	Fushë Kosovë	34,827	17,621	17,206	9,299	9,996	2,143	293	1	5	6	101	1,035,397	32	233,857	133	1,269,254	403,592	48,000	6,810	1,727,656	14	127,193	1,854,850	1,947,592.15	2,044,971.76
5	Gjakovë	94,556	47,226	47,330	26,654	26,423	12,123	1,130	1	9	15	251	2,563,948	51	330,702	301	2,894,650	1,113,668	120,000	17,025	4,145,343	32	296,784	4,442,127	4,664,233.45	4,897,445.12
6	Gjilan	90,178	45,354	44,824	19,771	29,288	9,358	1,160	1	7	10	244	2,491,266	44	294,361	288	2,785,627	1,037,621	86,400	12,258	3,921,906	32	296,784	4,218,690	4,429,624.85	4,651,106.09
7	Gilgocv	58,531	29,733	28,798	18,260	14,317	5,213	211	1	5	7	160	1,637,573	37	258,021	197	1,895,593	675,262	62,400	8,853	2,642,108	18	169,591	2,811,699	2,952,284.32	3,099,898.54
8	Hani i Elezit	9,403	4,836	4,567	1,824	2,778	560	73	1	0	1	40	416,008	22	166,276	62	582,284	111,857	9,600	1,362	705,103	5	42,398	747,500	784,875.30	824,119.07
9	Istog	39,285	19,677	19,608	10,607	10,235	3,093	464	1	4	8	112	1,147,608	35	245,971	146	1,393,579	451,591	57,600	8,172	1,910,941	14	127,193	2,038,134	2,140,041.09	2,247,043.14
10	Junik	6,064	2,995	3,069	1,595	1,681	420	35	1	0	0	37	379,667	22	166,276	59	545,943	74,180	4,800	681	625,604	5	42,398	668,001	701,401.44	736,471.51
11	Kacanik	33,409	16,970	16,439	9,054	9,683	1,940	200	1	4	8	98	999,057	35	245,971	132	1,245,027	366,462	57,600	8,172	1,677,261	14	127,193	1,804,454	1,894,676.58	1,989,410.41
12	Kamenicë	36,085	18,559	17,526	16,505	8,900	2,143	360	1	3	17	107	1,092,140	45	300,482	152	1,392,622	386,153	100,800	14,301	1,893,876	14	127,193	2,021,069	2,122,122.48	2,228,228.60
13	Klinë	38,496	19,193	19,303	10,272	11,398	2,606	200	1	3	9	112	1,147,608	36	252,027	147	1,399,635	439,759	62,400	8,853	1,910,647	14	127,193	2,037,840	2,139,732.20	2,246,718.81
14	Leposavic	13,773	6,969	6,804	3,443	2,754	965	-	1	0	1	51	517,699	23	172,332	74	690,031	147,014	9,600	1,362	848,007	5	42,398	890,405	934,925.17	981,671.43
15	Lipjan	57,825	29,430	28,395	15,355	17,461	7,042	706	1	4	7	158	1,620,359	36	251,964	193	1,872,322	696,663	57,600	8,172	2,634,757	18	169,591	2,804,348	2,944,565.83	3,091,794.12
16	Malishevë	54,613	26,661	27,952	36,430	20,758	3,622	640	1	6	7	153	1,582,743	37	258,021	190	1,840,763	629,401	62,400	8,853	2,541,417	18	169,591	2,711,008	2,846,558.08	2,988,885.98
17	Mamushë	5,508	2,672	2,836	2,543	2,670	737	15	1	0	0	33	343,326	22	166,276	55	509,602	76,094	4,800	681	591,177	5	42,398	633,574	665,253.17	698,515.83
18	Mitrovicë	71,909	36,275	35,634	18,624	20,351	5,074	1,200	1	11	10	197	2,009,908	43	288,305	239	2,298,213	795,874	86,400	12,258	3,192,745	23	211,989	3,404,733	3,574,969.89	3,753,718.39
19	Novobërdë	6,730	3,466	3,264	1,726	1,643	732	41	1	1	0	37	379,667	22	166,276	59	545,943	88,149	4,800	681	639,573	5	42,398	681,970	716,068.89	751,872.33
20	Obiliq	21,549	10,885	10,664	5,636	6,419	1,239	337	1	1	4	71	731,600	26	190,503	98	922,103	249,504	28,800	4,086	1,204,493	9	84,795	1,289,288	1,353,752.41	1,421,440.03
21	Pejë	96,451	50,466	49,985	21,930	33,320	10,783	1,047	1	9	14	258	2,639,817	49	324,646	307	2,964,463	1,099,397	115,200	16,344	4,195,403	32	296,784	4,492,187	4,716,796.78	4,952,636.62
22	Podujevë	88,499	44,955	43,544	23,385	27,061	5,122	879	1	3	18	237	2,425,916	47	312,532	284	2,738,448	966,033	105,600	14,982	3,825,062	28	254,386	4,079,449	4,283,421.08	4,497,592.14
23	Pristinë	198,897	99,361	99,536	54,800	51,403	25,008	2,143	1	15	15	505	5,156,904	70	433,541	575	5,590,445	2,342,266	148,800	21,111	8,102,621	64	593,568	8,696,190	9,130,999.21	9,587,549.17
24	Prizren	176,781	88,176	88,605	48,677	49,199	12,502	1,602	1	15	27	454	4,639,205	74	451,711	528	5,090,917	1,946,246	206,400	29,283	7,272,846	55	508,773	7,781,618	8,170,699.40	8,579,234.37
25	Rahovec	56,208	28,512	27,696	15,393	16,081	3,352	377	1	7	7	158	1,620,359	37	258,021	194	1,878,379	634,356	62,400	8,853	2,583,988	18	169,591	2,753,579	2,891,258.19	3,035,821.10
26	Shtërpcë	6,949	3,554	3,395	1,707	1,777	688	23	1	0	2	37	379,667	23	172,332	60	551,999	89,982	14,400	2,043	658,424	5	42,398	700,822	735,863.30	772,656.46
27	Shtime	27,324	13,850	13,474	5,874	7,877	2,200	38	1	4	0	84	861,025	26	190,503	110	1,051,528	322,454	14,400	2,043	1,390,424	9	84,795	1,475,220	1,548,980.67	1,626,429.71
28	Skenderaj	50,858	25,646	25,212	16,515	14,925	4,150	3,758	1	5	8	144	1,471,807	38	264,077	182	1,735,885	577,418	67,200	9,534	2,390,037	18	169,591	2,559,628	2,687,608.95	2,821,989.40
29	Suharekë	59,722	29,478	30,244	16,413	17,409	4,104	610	1	6	11	161	1,656,700	41	282,248	202	1,938,947	676,607	81,600	11,577	2,708,731	18	169,591	2,878,322	3,022,238.55	3,173,350.48
30	Viti	46,989	23,705	23,284	12,310	14,167	3,028	439	1	4	7	131	1,342,383	35	245,971	166	1,588,353	522,477	57,600	8,172	2,176,602	18	169,591	2,346,193	2,463,502.32	2,586,677.44
31	Vushtrri	69,870	36,004	33,866	18,146	19,634	4,508	800	1	10	9	184	1,887,815	40	276,191	224	2,164,006	771,126	76,800	10,896	3,022,828	23	211,989	3,234,817	3,396,557.69	3,566,385.58
32	Zubin Potok	6,616	3,408	3,208	1,456	1,588	476	38	1	0	0	37	379,667	22	166,276	59	545,943	78,688	4,800	681	630,112	5	42,398	672,509	706,134.84	741,441.58
33	Zveçan	7,481	3,661	3,820	95	117	45	1	1	0	0	37	379,667	22	166,276	59	545,943	78,798	4,800	681	630,222	5	42,398	672,619	706,250.34	741,562.85
34	Klokot	2,556	1,416	1,140	688	670	214	18	1	0	1	28	286,583	22	166,276	49	452,859	38,868	9,600	1,362	502,689	5	42,398	505,087	572,340.94	600,957.99
35	Mitrovica Verior	12,326	6,272	6,054	2,686	2,931	879	82	1	0	0	51	517,699	23	172,332	74	690,031	142,008	4,800	681	837,520	5	42,398	879,918	923,913.82	970,109.52
36	Partesh	1,787	922	865	477	340	202	-	1	0	2	24	250,242	23	172,332	47	422,575	31,096	14,400	2,043	470,114	5	42,398	512,512	538,137.08	565,043.94
37	Ranillug	3,866	1,969	1,897	1,012	393	259	-	1	0	0	28	286,583	21	160,219	48	446,802	50,478	4,800	681	502,761	5	42,398	545,159	572,416.73	601,037.56
38	Gracanice	10,675	5,428	5,247	2,463	2,661	993	81	1	3	11	47	481,358	35	232,901											

KOMUNA:	Të gjitha				Nr. Banorëve:	1,779,249	Shërbimi i Urgjencës	
Stafi Mjekësor	Raporti për një njësi stafi	Nr. i Stafit në KPSH (I kalkuluar)	Koeficienti	Shtetas	Paga Bruto Mujore	Shpenzimet vjetore për Paga dhe Shtesa	Nr. i Stafit (Urgjencës)	Shpenzimet për Paga dhe Shtesa (Urgjencës)
Mjek Familjar:	2,000 Banor	909	12.00		1,320	15,118,488	137	2,278,584
Infermier/e Familjare:	1,000 Banor	1,818	5.40		594	13,606,639	274	2,050,726
Mjek Stomatolog:	5,000 Banor	374	7.40		814	3,835,894	-	-
Teknik Stomatolog:	5,000 Banor	374	5.40		594	2,799,166	-	-
Pedodont:	5,000 Banor	122	12.00		1,320	2,029,104	-	-
Mjek Biokimist:	50,000 Banor	58	12.00		1,320	964,656	-	-
Farmacist i Diplomuar:	1 QKMF	38	12.00		1,320	632,016	-	-
Teknik i Farmacisë:	50,000 Banor	96	5.40		594	718,502	-	-
Teknik Laborante:	10,000 Banor	195	5.40		594	1,459,458	-	-
Radiolog:	2 QKMF	76	12.00		1,320	1,264,032	-	-
Teknik Radiologjisë:	4 QKMF	152	5.40		594	1,137,629	-	-
Mami e diplomuar:	QKMF	-	5.40		594	-	-	-
Mjeku gjinekolog:	QKMF	-	12.00		1,320	-	-	-
Mjek pediater-Neonatolog:	QKMF	-	12.00		1,320	-	-	-
Bashkpuntor profesional:	Banor	-	5.40		594	-	-	-
Logoped:	70,000 Banor	48	5.60		616	372,557	-	-
Psikolog:	70,000 Banor	48	7.00		770	465,696	-	-
Fizioterapeut:	70,000 Banor	48	5.60		616	372,557	-	-
Punëtor Social:	70,000 Banor	48	5.40		594	359,251	-	-
Gjithsejt Staf Mjekësor:		4,404				45,135,644	411	4,329,310
Staf zëvendësues:	15%	661				6,770,347	62	649,396
Gjithsejt Staf Mjekësor & zëvendësues:		5,065				51,905,991	473	4,978,706
Stafi mjekësor për 1,000 banor:		2.48						
Stafi Administrativ								
Drejtor QKMF:	1 QKMF	38	12.50		1,375	658,350	-	-
Zv. Drejtor QKMF:	1 QKMF	23	12.00		1,320	382,536	-	-
Kryeshf. Dep. Admin:	1 QKMF	38	8.30		913	437,144	-	-
Kryeinfermieri i QKMF:	1 QKMF	38	6.00		660	316,008	-	-
Udhëheqës Njësie:	2 QKMF	76	7.20		792	758,419	-	-
Koordinator SISH:	1 QKMF	38	7.20		792	379,210	-	-
Depoist:	1 QKMF	38	5.00		550	263,340	-	-
Arkivist:	1 QKMF	38	5.00		550	263,340	-	-
Shtëpiak:	1 QKMF	38	3.76		414	198,032	-	-
Asistent:	2 QKMF	76	4.10		451	431,878	-	-
Zyrrar:	3 QKMF	114	5.00		550	790,020	-	-
Shofer:	2 QKMF	76	3.80		418	400,277	137	721,552
Pastrues:	5,000 Banor	465	3.80		418	2,449,062	-	-
Sigurim:	50,000 Banor	58	3.76		414	302,259	-	-
Gjithsejt Staf Administrativ:		1,154				8,029,874	137	721,552
Staf zëvendësues:	15%	173				1,204,481	21	108,233
Gjithsejt Staf Admin. & zëvendësues:		1,327				9,234,355	158	829,784
TOTAL Stafi Mjekësor & Administrativ:		5,358				53,165,519	548	5,050,861
TOTAL Stafi Mjekësor, Admin. & zëvendësues:		6,392				61,140,346	630	5,808,490
Mallra dhe Shërbime	Planifikimi i vizitave /shërbimeve	Nr. i vizitave /shërbimeve			Kosto për njësi	Shuma totale vjetore		
Planifikimi i Vizitave:	2.0 Banor	3,558,498			2.00	7,116,996	-	-
Planifikimi i Shërbimeve:	2.0 Banor	3,558,498			2.00	7,116,996	-	-
at në shtëpi për shtat.&fëmij:	7.0 Banor	213,339			10.00	2,133,390	-	-
at në shtëpi për kujd.paliativ:	0.7 Banor	105,150			20.00	2,103,000	-	-
ajtimi i mbeturinave mjeksore:	1 Kq	60,096			4.50	270,432	-	-
Kampania informuese:	1 QKMF	38			5,000.00	190,000	-	-
Trajnime për stafin mjekësor:	2 Trajnime	8,808			150.00	1,321,200	-	-
Shpenzimet e mirëmbajtjes së obj.	227 IKPSH	99,199			3.00	297,597	-	-
Mallra dhe Shërbime:						20,549,611		
Shpenzimet Komunale	Raporti për një njësi	Numri i kalkuluar i			Kosto mujore për një njësi	Shuma totale vjetore		
Shpenzimet Komunale:	1 IKPSH	437			400.00	2,097,600	-	-
Shpenzimet Komunale:						2,097,600		
TOTAL GRANTE:						83,787,557		89,396,048

* Përkater(4) profesionistët shëndetësor (Mjek Familjar, infermier/e familjare, Mjek stomatolog dhe Teknik Stomatolog) standartet janë të bazuara në UA 04/2020 për KPSH.
* Për shtatë (7) profesionistët tjerë (Pedodont, Mjek biokimist, Farmacist i Diplomuar, Teknik i Farmacisë, Teknik Laborant, Radiolog, Teknik i Radiologjisë) UA 04/2020 për KPSH nuk i ka përcaktuar standartet. Propozimi i Standartëve në këtë formulë është bërë vetëm për financim.

1.1. Financimi për Shëndetësi sekondare

Financimi për shëndetësinë sekondare për vitin 2025 është në shumë prej 2,603,077 euro sipas propozimit nga MSH dhe projeksioneve të KASH për tri komunat minoritare, si vijon:

- Komuna e Shtërpcës, në shumë prej 522,371 euro,
- Komuna e Mitrovicës së veriut, në shumë prej 989,935 euro, dhe
- Komuna e Graçanicës, në shumë prej 1,090,771 euro.